

Dorëzohen në polici dy të dyshuarit për tentim vrasjen në Vitomiricë të Pejës

LAJME



11/12/2023 10:05



Policia e Kosovës ka njoftuar se dy të dyshuarit për tentim-vrasjen e djeshme në Pejë, janë dorëzuar vullnetarisht.

Këtë, Policia e ka bërë të ditur me anë të një komunikate për media, shkruan lajmi.net.

Bëhet fjalë për një person të lindur më 2003 dhe një tjetër të lindur më 2006.

Njoftimi i plotë nga Policia

Më datë 10 dhjetor 2023 rreth orës 01:25, Policia është informuar se në rrugën “Zekë Berdyna” në fshatin Vitomericë ka të shtëna me armë zjarri.

Policia menjëherë iu ka përgjigjur vendit të ngjarjes dhe me të arritur në atë lokacion nga viktimat kanë kuptuar se në drejtim të tyre nga persona të pa njohur është shtënë me armë zjarri.


Pas këqyrjes së vendit të ngjarjes, janë mbledhur dëshmi, bazuar në sekuestrimin e dëshmimeve të dyshuarit e këtij rasti janë vetë dorëzuar.

2003. K. i lindur me 2003.

2004. K. i lindur me 2006.

Pas intervistimit të dyshuarave nga ana e hetuesve rajonal në prezencën e avokatit mbrojtës, me urdhër të prokurorit shtetit të njëjtit janë ndaluar. **/Lajmi.net/**

Artikuj të ngjashëm



December 11, 2023

Gjykata merr vendim për të arrestuarin e katërt në rastin e Liridonës



December 11, 2023

Kurti takon Scholz, flasin për dialogun e situatën në rajon e...



December 11, 2023

35 aktakuza ndaj 99-të personave gjatë 24-të orëve të fundit



December 11, 2023

Jeremiq: Kosova nuk duhet të hyjë në OKB, duhet ta refuzojmë...



December 11, 2023

Sërish rritet çmimi i naftës



December 11, 2023

Flet ish-mësuesja e Liridonës: Ka qenë e zgjuar, Naimi e meriton...